

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

5 Shkurt 2021

Të Dashur Familjarët të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Të Hënën, ne mirëpresim mësuesit tanë PreK-2 dhe personelin ndihmës të shkollë përsëri në shkolla në mënyrë që ata të angazhohen në zhvillimin profesional për të forcuar më tej aftësitë e tyre udhëzuese dhe për të ndihmuar në përgatitjen e klasave të tyre në mënyrë që të mundemi *ngadalë dhe me kujdes* të fillojmë fazat me studentët tanë PreK-2 për të mësuar në - person për herë të parë në gati një vit. Ky personel po bashkohet me qindra drejtorët, inxhinierët e ndërtesave dhe personelin tjetër të mirëmbajtjes, personelin e transportit dhe shërbimit të ushqimit të cilët kanë punuar në mënyrë të sigurtë në shkolla që nga pranvera e vitit 2020 për të vendosur shumë masa shëndetësore dhe të sigurisë që janë provuar të mbajnë rrezikun e transmetimit të ulët të COVID – 19 kur zbatohen - nga pajisjet mbrojtëse personale për të gjithë studentët dhe personelin , rregullimet e reja të klasave dhe banjove, për distancën sociale dhe ndarjet me pleksiglas në zyra, të pastruesit e duarve dhe stacionet e hidratimit, sinjalizimi i sigurisë, testimi i ventilimit në të gjitha shkollat, dhe riparime, përmirësime dhe riprovime aty ku është e nevojshme.

Pajisjet dhe ekipi ynë i mirëmbajtjes u desh të ndërpresin punën e tyre për disa ditë për t'u përgatitur për stuhinë e borës në fillim të kësaj jave dhe për të pastruar në mënyrë të sigurtë ndërtesat tona nga më shumë se pesë “inches” dëborë. Shpërndarja e PPE nga depot tona në disa shkolla gjithashtu u vonua për shkak të stuhisë. Inxhinierët e ndërtesave tani kanë rifilluar punën e tyre brenda shkollave dhe shpërndarja e PPE dhe mjeteve të tjera të sigurisë pritet të përfundojnë deri në fillim të javës së ardhshme. Drejtuesit e mi me përvojë dhe unë gjithashtu kemi përfunduar hulumtime në shkollë këtë javë për të ndihmuar në identifikimin dhe raportimin e përgatitjeve të masave dhe sigurisë të nevojshme para se studentët të kthehen në shkolla të Hënën, 22 Shkurt. Angazhimi im ndaj jush është që nëse një klasë nuk është gati, ne nuk do ta përdorim atë. Nëse një shkollë nuk është gati, ne nuk do ta hapim atë.

Ne vazhdojmë të punojmë me Departamentin e Shëndetit Publik të Filadelfias për planet e testimit të shpejtë për studentët dhe personelin , dhe që i gjithë personeli i Drejtorisë të ketë mundësi në vaksinën COVID-19 sa më shpejt të jetë e mundur. Pasi të jenë të disponueshme vaksinat, ne do të aktivizojmë vendet e shkollës në të gjithë qytetin në mënyrë që personeli ynë, të mund të vaksinohet lehtësisht nëse zgjedhin kështu.

Ne jemi kontaktuar nga shumë familje PreK-2 të cilët fillimisht kanë zgjedhur të mbeten virtualë, por tani janë të interesuar në modelin hibrid të të mësuarit. Ju lutemi ta dini se ne jemi duke punuar në procesin e regjistrimit dhe do të ndajmë informacionin sa më shpejt që të kemi punuar me detajet.

Siç e kam thënë shumë herë më parë, shëndeti dhe mirëqenia e të gjithëve në shkollat tona është dhe mbetet përparësia jonë më e lartë pasi ngadalë dhe me kujdes hapim dyert e shkollës për studentët dhe personelin për herë të parë në gati një vit. Nuk do të jetë perfekte. Por duke punuar së bashku, me të gjithë që bëjnë punën e tyre, ne mund ta bëjmë këtë në mënyrë të sigurtë.

Sinqerisht,

A handwritten signature in cursive script that reads "William R. Hite Jr." followed by a small flourish.

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias